



BULETIN JAVOR

20-24 MAJ 2024



PËRMBAJTJA

- Western Balkan Cyber Camp Udhëtimi Fantastik 3 Ditor në Botën e Sigurisë Kibernetike
- Trajnim i AKSK me studentët në Universitetin New York
- Pjesëmarrja e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në Aktivitetin "Cyber Threat Intelligence"
- AKSK Trajnon Studentët e Universitetit Metropolitan për Sigurinë Kibernetike

Western Balkan Cyber Camp Udhëtimi Fantastik 3 Ditor në Botën e Sigurisë Kibernetike



Kështu përfundoi udhëtimi fantastik 3 ditor i aktivitetit më të madh rajonal për të rinjtë në sigurinë kibernetike, Western Balkans Cyber Camp!

Jemi të lumtur dhe mirënjohës për çdo pjesëmarrës, që e ka bërë këtë event të përvitshëm më të pëlqyerin e të gjithëve!

Trajnim i AKSK me studentët në Universitetin New York

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) zhvilloi në datë 16 Maj trajnim me studentët në Universitetin New York. Ky trajnim u udhëhoq nga ekspertë të Autoritetit ku u diskutuan tematikat mbi:

- Sigurinë Kibernetike
- Menaxhimin e një incidenti kibernetik ku u shpjeguan se cilat janë hapat që ndërmerren gjatë menaxhimit të një incidenti kibernetik
- Pjesa praktike (Cyber Drill Exercise) ku u krye një simulim i rasteve të një incidenti kibernetik.

Qëllimi i këtij trajnimi është rritja e kapaciteteve të studentëve dhe aftësimi i tyre në fushën e sigurisë kibernetike





20-24 MAJ 2024

Pjesëmarrja e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në Aktivitetin "Cyber Threat Intelligence"



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike mori pjesë në aktivitetin një-javor "Cyber Threat Intelligence", të organizuar nga Instituti Amerikan për Qeverisje të Sigurtë, me prezencën e përfaqësuesve nga institucionet kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes.

Qëllimi i aktivitetit ishte të thellojë njohuritë e pjesëmarrësve dhe aftësitë e tyre për të kuptuar, vlerësuar dhe integruar inteligjencën e kërcënimeve kibernetike në operacionet e sigurisë kibernetike.

Ky aktivitet dëshmon mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për institucionet shqiptare të sigurisë, si dhe angazhimin e përbashkët në rritjen e kapaciteteve mbrojtëse ndaj kërcënimeve për të arritur një ekosistem kibernetik të sigurt dhe të qëndrueshëm në vend.

AKSK Trajnon Studentët e Universitetit Metropolitan për Sigurinë Kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) zhvilloi në datë 21 Maj trajnim me studentët e Universitetit Metropolitan. Ky trajnim u udhëhoq nga ekspertë të Autoritetit ku u diskutuan tematikat mbi:

- Sigurinë Kibernetike
- Menaxhimin e një incidenti kibernetik ku u shpjeguan se cilat janë hapat që ndërmerren gjatë menaxhimit të një incidenti kibernetik
- Pjesa praktike (Cyber Drill Exercise) ku u krye një simulim i rasteve të një incidenti kibernetik

Qëllimi i këtij trajnimi është rritja e kapaciteteve të studentëve dhe aftësimi i tyre në fushën e sigurisë kibernetike.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.cesk.gov.al



@autoriteti_kombetar_sk



+355 422 21 039